



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 61 parag. 1.8, të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, si dhe në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, si dhe në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2019, merr,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Me këtë vendim vëhen në diskutim publik:

- *Propozim Rregullorë për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës*
- *Propozim Rregullorë për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës*

Neni 2

1. Diskutimi publik për propozim Rregullorë për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës zgjat 30 ditë përkatësisht prej **03.06.2019 deri më 03.07. 2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më **17.06.2019, në orën 10;00**, në objektin e Komunës, salla e Kuvendit, dhe zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim dhe koordinim me Grupin Punues për hartimin e propozimit në fjalë, dhe shërbimet tjera përkatëse.
2. Diskutimi publik për propozim Rregullorë për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës zgjat 30 ditë përkatësisht prej **03.06.2019 deri më 03.07. 2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më **18.06.2019 në orën 10;00**, në objektin e Komunës, salla e Kuvendit, dhe zbatohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjen dhe Shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Grupin Punues për hartimin e propozimit në fjalë, dhe shërbimet tjera përkatëse.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.32, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe bujar.gimolli@rks-gov.net të cilat pastaj i përcjellin në Drejtorinë përkatëse dhe tek Grupi punues për hartimin e Propozim Rregullorëve në fjalë.

Neni 4

Dokumentet e Propozim Rregullorëve sipas nenit 1, publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës
<http://kk.rks-gov.net/podujeve>

Neni 5

Diskutimet publik e zbatohen nga Drejtoritë e cekura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 1 të këtij Vendimi në bashkëpunim me Grupin punues të ngritur nga Kryetari i Komunës me Vendimin nr.02-020/04-0033331/19 të datës 18 prill 2019, dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që obligohen të përgatitin raportin nga diskutimi publik dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimet ose mospranimet të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-070/05-0043565/19
Podujevë, 31 maj 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi